

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË PREJ
VITIT 1991

DEKLARATA E DËSHMITARIT

TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:

Mbiemri: BALAJ **Emri:** Shaban
Emri i babait: Binak **Emri i nënës:** Nifë
Nofka: **Gjinia:** Mashkull
Datëlindja: 14 tetor 1956 **Vendlindja:** Strelcë i Ulët, komuna e Deçanit
Origjina etnike: Shqiptar i Kosovës **Përkatësia fetare:** Musliman

Adresa:

Gjuhë të folura: shqip, serbisht, gjermanisht

Gjuhë të shkruara: shqip

Gjuhë të përdorura në intervistë:

Profesioni i tashëm: Vozitës

I mëparshëm:

Data e intervistës: 2 qershor 2007, 8 qershor 2007 (pas korigjimit nga ana e dëshmitarit)

Intervistues: Christopher Gosnell

Përkthyes: Danila NIKA

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës: Christopher Gosnell, Rut Ley, Shahzada Sultan, Danila Nika, Shaban Balaj

Nënshkruar/Inicialet: /nënshkrim/

Nënshkrimi / Inicialet: Te tjere te pranishem:

DEKLARATA E DËSHMITARIT

1. Më është kërkuar të jap një deklaratë për Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë (TPNJ). Nuk më ka kërcënuar apo detyruar njeri të vij këtu, nuk më kanë premtuar asgjë, dhe nuk më kanë dhënë ndonjë stimul që ta bëj këtë.
2. Kam rënë dakort të jap një deklaratë me shkrim dhe ta nënshkruaj atë. Më kanë njoftuar se, në rast se ndonjë prej personave për të cilët do të flas në këtë deklaratë, do të akuzohet prej TPNJ-së, emri im mund t'u bëhet i ditur avokatëve mbrojtës të të akuzuarve dhe publikut të gjerë. Jam i gatshëm të dëshmoj para TPNJ-së, në Hagë, Holandë, dhe e kuptoj se, në rast se më kërkohet të dëshmoj, Gjykata do të marrë të gjitha masat e sigurisë për mua. Pranoj që një kopje e kësaj deklaratë t'i jepet policisë së UNMIK-ut, apo ndonjë organi tjetër të zbatimit të ligjit, që heton akuza për krime lufte të kryera në Kosovë gjatë konfliktit të fundit.
3. Jam intervistuar më parë nga Zyra e Prokurorisë (OTP) në vitin 2002 dhe përsëri në vitin 2006 në lidhje me vrasjen e motrës sime Sanije BALAJ në gusht të vitit 1998. Kjo deklaratë është shtesë dhe sqarim i atyre deklaratave.
4. Unë u bashkova me UÇK-në në fund të marsit më 1998 kur u formua kjo organizatë në fshatin tim. Njerëzit morrën iniciativën për të ruajtur fshatin pasi dëgjuam se Gllogjani (Gllogjani i Ramush Haradinajt) u armatos. Kontaktua ish banorët e fshatit të cilit ishin jashtë për të dërguar të holla për armatim.
5. Në fund të marsit, një javë deri në dhjetë ditë pas ofensivës serbe në Gllogjan gjatë së cilës tre persona u vranë, një grup prej 40 vetave prej fshatit u nisën për në Shqipëri për të marrë armatim dhe pajisje. Kushërinjtë e mij Haziri dhe Hamdiu ishin në këtë grup. Në Voksh, mes Pobergjanit dhe Junikut, 500 veta prej fshatrave të ndryshme ishin mbledhur për të nisur udhëtimin nëpër male për në Shqipëri.
6. Kemi ecur gjatë natës dhe arritëm në Tropojë, Shqipëri në mëngjes. Para se të niseshim organizuam takimin me tre ish banorë të fshatit që vinin nga jashtë me të holla për të blerë armatim dhe pajisje. Ata ishin Tahir Gjokaj (i cili vdiq në 2003), Bajram Gjokaj i cili jeton në Zvicër dhe Brahim Zeqaj. Ata sollën 100.000 marka gjermane, prej të cilave shpenzuam 70.000 për armë dhe për marrjen e kuajve me qera

Nenshkrimi / Inicialet: *Bajram Gjokaj* *St...* Te tjere te pranishem: *[Signature]*

[Signature]

për transportim të armëve në Kosovë. 30.000 DM e mbetura ia sollëm fshatit për mbështetje bamirësie. Armatimin e kemi blerë në Bajram Curri, në treg, në Tropjë. Unë e bleva një Kallashnikov, pushkë dhe minahedhës. Një Kallashnikov kushtonte 70-100 DM, ndërsa një kuti me 650 fishekë për Kallashnikov kushtonte 30 euro. Grupi ynë bleu Kallashnikov, pushkë të tipit 20, pushkë të tipit 10, mitraloz gjysmë automatikë 9mm, 5 Gulinov 15mm (mitraloz me këmbëza, peshonin rreth 100 kg) gjashtë mortaja dhe dy snajper. Municioni ishte kinez.

7. Natën e kemi kaluar në Tropjë dhe u nisëm për t'u kthyer në Kosovë. Shkuam në dy grupe, secili me rreth 20 kuaj të ngarkuar me armatim. Haziri shkoi me grupin e parë, Hamdiu dhe unë në grupin e dytë. Rruga për në kthim në Kosovë së pari na nxorri në Jasiq të Epërm në Kosovë ku i morrëm disa traktorë të braktisur dhe i ngarkuam armatimin aty. Prej këtu shkuam në Junik ku u takuam me 4 ushtarë të UÇK-së të cilët na përcollën, dhe pastaj në Rracaj. Dy ose tre ushtarë na prisnin në Rracaj të cilët na shoqëruan deri në Gllogjan. Prej këtu udhëtuam nëpër fshatra prapa Strellicit, sepse forcat serbe ishin në rrugën kryesore. Nuk u sulmuam gjatë kthimit prej Shqipërisë.
8. Ky ishte udhëtimi i vetëm për në Shqipëri për të marrë armë, por dija për kolona të tjera prej Kosovës në Shqipëri gjatë kësaj periudhe në fund të marsit. Njerëz të tjerë të fshatit shkonin dhe ne bisedonim për këtë gjë. Di për kolona të banorëve të fshatrave siç janë Lutogllava, Zablaq, Neberxhan, Dubrava, Botisaq dhe Zahaq. Shumica e kolonave shkonin përmes Gllogjanit sepse kjo ishte rruga më e sigurtë për në Gllogjan. Ishte edhe një rrugë tjetër përmes Carrabregut, por edhe përmes Strellicit, por këto rrugë ishin më të rrezikshme.
9. Natën e 7 ose 8 majit 1998 i takova rreth 100 njerëz që vinin nga Drenica e që shkonin për Shqipëri për të marrë armë. Unë i përcolla deri prej Dubovikut deri në Gllogjan. I takova rastësisht në Dubovik dhe i pyeta se ku po shkonin. Donin të blenin armë në Shqipëri por nuk e dinin rrugën mirë. Unë i shoqërova dhe iu tregova rrugën për në Gllogjan. Eca me ta deri në Irzniq dhe prej këtu iu tregova rrugën për në Gllogjan dhe iu thashë ditën e mirë. Kolonat udhëtonin natën sepse as policia as ushtria serbe nuk lëviznin natën.
10. I pyetur se si grupet e UÇK-së komunikonin me fshatrat e ndryshme, unë mund të them se udhëheqësi i secilit fshat caktonte një person për kontakte, i cili ishte

Nenshkrimi / Inicialet: ... *Saban* ... *Bun* ... Te tjere te pranishem:

përgjegjës për këto komunikime. Secili fshat kishte telefonin satelitor të sjellur nga jashtë dhe fshatrat ishin në kontakt të shpeshtë me njëri tjetrin dhe me shqiptarët që jetonin jashtë dhe donin të dinin për situatën në fshatra. Familjarët thirrnin nga jashtë çdo natë.

11. Prej fundit të marsit deri nga mesi i gushtit 1998 serbët ishin të pozicionuar përgjatë rrugës Pejë-Gjakovë. Në Strelcin e Epërm ishin dy postblloqe afër rrugës kryesore: njëri afër pompës së benzinës dhe tjetri te një kooperativë bujqësore. Ushtarët në këto pozicione bashkuan forcat për të na sulmuar në fund të qershorit rreth një orë përfshirë këtu edhe të shtënat prej automjetit të blinduar. Askush nuk u lëndua. Një pozitë tjetër serbe me rëndësi, ishte në rrugën kryesore, që gjendej në udhëkryqin me rrugën për në Prilep. Në pozicionin serb aty ishin rreth 100 ose 200 ushtarë dhe paramilitarë serb. Pozicione të tjera serbe në rrugën Pejë-Gjakovë gjatë kësaj periudhe gjendeshin në Skivjan dhe Piskotë. Forcat serbe ishin të pranishme edhe në Deçan, Lebushtë, Isniq, Lubeniq (afër varrezave) në Raushiq (afër stacionit të autobusëve, rreth 50 metra prej rrugës kryesore) dhe Brezanik.

12. Nganjëherë forcat serbe hynin nëpër fshatrat në anën lindore të rrugës kryesore qëndronin dy-tri orë dhe ktheheshin në bazë. Për shembull, ata kanë hyrë në Lebushtë, Prejlep, Carrabreg. Në maj forcat serbe prej pozicionit në Çallapek sulmuan Baranin dhe Vranocin dhe e mbajtën fshatin për dy-tri orë. Pesë persona u vranë. Në fillim të qershorit stacioni i policisë serbe mes Çallapekut dhe Rosujës në Sedovë është djegur nga UÇK-ja dhe forcat serbe lëshuan këtë pozicion. Një shembull tjetër i këtij sulmi ndodhi në Strelc të Epërm.

13. Mes fundit të majit dhe mesit të gushtit 1998, përveç sulmeve të lartpërmendura, forcat serbe kryesisht i kufizuan nëpër lokacionet përgjatë rrugës Pejë-Gjakovë. Sidoqoftë, unë di për pozicione të forcave serbe në këto lokacione: kooperativa bujqësore në Junik, fabrika e teksilit në hyrje të Junikut, të Suka e Hereçit, Suka e Radoniqit, Suka e Baballoqit dhe Suka e Biteshit. Mësova për këto pozicione në bazë të të shtënave artilerike prej këtyre pozicioneve dhe marrëdhënieve me njerëz të tjerë. Serbët hapën istikame në Sukën e Biteshit dhe shtinin prej asaj lartësie.


14. Mes fundit të marsit dhe 16 gushtit 1998 nuk ka pasur këmbësori serbe të vendosur në Irzniq, Ratish të Epërm osë Ratish të Ulët. Forcat serbe ishin në kamp të refugjatëve

Nenshkrimi / Inicialet: ... *S. Salim* ... *B. ...* Te tjere te pranishem: ... *[Signature]* ...

në Baballoq përgjatë rrugës kryesore, gjithashtu edhe në kodër, Suka e Baballoqit, por nuk ishin afër fshatit Baballoq.

15. Për herë të parë uniformën e UÇK-së e mora në Shqipëri gjatë udhëtimit atje në fund të marsit. Uniformat e UÇK-së ishin kamuflazh shpesh herë të ushtrisë gjermane, amerikane ose shqiptare. Uniformat e UÇK-së kishin emblemën e qepur në krahë, në gjoks dhe në kapelë e cila ishte katrore me strehë, e ngjashme me ato që ka sot SHPK-ja.
16. Në deklaratën time të parë, kam përmendur letrat me të cilat lejohej lëvizja. Këto letra ishin letra autorizimi të lëshuara nga ana e komandantëve të UÇK-së të fshatrave për të autorizuar udhëtime specifike përbrenda zonës së UÇK-së. Postbllokun e parë të UÇK-së e kam parë në Rasiq menjëherë pas kthimit tim nga Shqipëria në fund të marsit. Letrat e autorizimit për udhëtim nevojiteshin për kalim nëpër këto postblloqe, nëse nuk e kishe letrën e autorizimit të kthenin prapa. Në këto letra shkruhej emri i personit, vendi ku shkonte, emri i fshatit ku banonte, emri i komandantit të UÇK-së, data e lindjes dhe vuaja e UÇK-së. Pothuajse çdo fshat brenda veriut dhe perëndimit të liqenit të Radoniqit kishte postbllok të UÇK-së deri në shtator 1998. Unë kisha letrën e udhëtimit të lëshuar nga Gani Gjukaj. Letra e autorizimit për udhëtim nevojitej për çdo udhëtim në atë pjesë.
17. Gani Gjukaj ishte komandant fshati në Strelc. Pranova urdhra nga ai deri në gusht 1998 kur dhashë dorëheqje. Nën komandën e tij ishin rreth 200 ushtarë të UÇK-së. Të gjithë i zbatonin urdhërat e tij. Ishte njeri i sigurtë dhe i shkolluar dhe ai e vendosi UÇK-në në fshat. Pastaj arriti Tahir Zemaj dhe Gani Gjukaj punonte për të. Tahir Zemaj hyri në Kosovë me urdhër të Ahmet Krasniqit.

18.



Nenshkrimi / Inicialet: ... *Tahir Zemaj* ... Te tjere te pranishem: ... *[Signature]* ...

[Handwritten signature]


19.

20.

21.

22.

23.



Nenshkrimi / Iniciallet: *Stam Prunç* Te tjere te pranishem: *ca*

Handwritten signature and initials

24.

25.

26.

27.

28.

29.

Nenshkrimi / Inicialet: ... *J. B.* ... Te tjere te pranishem: *ca* ...

Hi *DMT*

30.

31.

32.

33.

VËRTETIM I DËSHMITARIT


Kjo deklaratë më është lexuar në gjuhën shqipe dhe përmban të gjitha që i kam thënë sipas njohurisë sime dhe me sa mbaj mend. Deklaratën e kam dhënë vullnetarisht dhe jam i vetëdijshëm se mund të përdoret në procedurë gjyqësore para Gjyqit Ndërkombëtar për

Nenshkrimi / Inicialet: *Skender Durani* Te tjere te pranishem: *[Signature]*

Faqja 8 e 9

[Signature]
[Signature]

Përndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991 dhe se mund të thirrem të dëshmoj publikisht para Gjyqit.

Nënshkrimi: 

Data: 8. 6. 2007

VËRTETIM I PËRKTHYSES

Unë Danila Nika, përkthyes, vërtetoj se:

1. Jam e kualifikuar dhe e miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar Shaban Balaj se ai e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e Shaban Balaj, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. Shaban Balaj ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, të përkthyer prej meje, janë të vërteta, me sa di dhe sa i kujtohet, dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Data: 28/04/2007

Nënshkrimi: 

Nënshkrimi / Inicialet:  Te tjere te pranishem:

Faqja 9 e 9

